



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:207881
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05725256

AA.nr.661/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët; Hajriz Hoti kryetar, Ramiz Kuqi dhe Delushe Halimi anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Hajrije Krasniqi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, M.L nga Gjilani, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit, Halit Azemi, avokat nga Gjilani, kundër të paditurës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidëve të Luftës dhe Viktimave Civile me seli në Prishtinë, e cila përfaqësohet nga Avokatura Shtetërore pranë Ministrisë së Drejtësisë, me bazë juridike nxjerrje e aktit administrativ, përkritazi me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2124/2021, të datës;19.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë;20.05.2024, merr këtë,

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, M.L nga Gjilani, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2124/2021, i datës;19.05.2023, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.2124/2021, të datës;19.05.2023, është vendosur, “*I. REFUZOHET si e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësit M.L nga Gjilani, me të cilën ka kërkuar që Gjykata të detyroj organin e paditur të nxjerr akt administrativ. II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.*”

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësi përmes të autorizuari të tij, Halit Azemi, avokat nga Gjilani, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit dhe aktgjykimi i goditur të priset dhe lënda të kthehet në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka ushtruar pala e paditur.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre duke u bazuar në nenin 49 paragrafi 1 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 194 dhe 195.1 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka gjetur se ankesa e paditësit është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datë; 17.09.2021 dhe ka kërkuar nga Gjykata që ta detyroj të paditurën ta përmbushë detyrimin ligjor konform nenit 68 paragrafi I, pika 1 dhe 2 e LKA-së.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit të paraqitur për nxjerrjen e aktit administrativ dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin e refuzon si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se *“Gjykata, vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor publik dhe gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar. Paditësi i është drejtuar me kërkesë Ministrisë Financave, Punës dhe Transfereve -Departamenti për Familjet e Dëshmorëve, Invalidët e Luftës dhe Viktimave Civile si organ i paditur për njohjen e te drejtës së pensionit të Veteran të UÇK-së mbështetur me disa dëshmi dhe prova të administruara më lartë. Organi i paditur në vendimin e atakuar kërkesën e palës e refuzon duke iu referuar nenit 16 para. 4 të Ligjit nr. 04/L261 për Veteranët e Luftës së UÇK-së që ka të bëjë me atë se veteranët e UÇK-së të cilët janë të punësuar në sektorin publik dhe privat nuk kanë të drejtë të përfitimit të pensionit. Paditësi ka ushtruar ankesë ndaj vendimit të organit të shkallës së parë në Komisionin e ankesave MPMS-së por ankesa refuzohet me vendimin e dt.22.04.2021 si e pa bazuar, pasi që i njëjti nuk i ka plotësuar kriteret siç kërkohet me ligj. Gjykata për të vlerësuar ligjshmërinë e këtij akti, i referohet Udhëzimi Administrativ nr.01/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 06/2012 për procedurat e aplikimit në skemën e pensioneve dhe beneficioneve të përcaktuara në Ligjin nr.04/l-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre ka përcaktuar se Dokumentacioni i nevojshëm për realizimin e pensionit të veteranit-luftëtar të UÇK-se, krahas kërkesës për realizimin e pensionit të veteranit-luftëtar të UÇK-se, duhet të paraqesë edhe këto dokumente: Dokumenti i identifikimi të aplikantit (letërnjoftimi), në kopje Vërtetimin e lëshuar nga Zyra për çështjet e Kategorive të Dala nga Lufta; Certifikata e lindjes së aplikantit, e nxjerre në gjashtë muajt e fundit, në origjinal; Certifikatat e lindjes së fëmijëve të Veteranit të UÇK-se, në origjinal dhe Vërtetimi nga ATK-ja, që nuk është në marrëdhënie pune. Andaj Gjykata gjen se i takon paditësit që të dëshmojë dhe dokumentoj përmes vërtetimit nga ATK siç përcaktohet me Udhëzimin Administrativ nr.01/2015 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr.06/2012 për procedurat e aplikimit në skemën e pensioneve dhe beneficioneve se nuk është i punësuar në asnjë institucion publik apo privat dhe kjo dëshmi ose provë është ndër kriteret themelore juridike për realizimin e së drejtës për pension të veteranit të UÇK-së. Edhe Gjykata Kushtetuese e Kosovës në çështjen KO 01/17 dt. 4 prill 2017 (Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-261 për veteranet e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës) ka nënvizuar rëndësinë e këtij kriteri duke shtuar se “skema e pensionit do të vazhdojë të implementohet siç është parapare në ligjin bazik deri në kategorizimin përfundimtar të listës së veteraneve të UÇK-se dhe ata që janë të punësuar në sektorin publik ose privat nuk kanë të drejtë në pension”. Gjykata ka vlerësuar dhe pretendimet e paditësit si në padi se nuk është vërtetuar drejt gjendja faktike dhe nuk është aplikuar e drejta materiale mirëpo si të tilla gjykata i refuzoj si të*

pabazuara, sepse nga vendimi i te paditurës i datës 22.04.2021 rezulton se paditësi nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara për përfitim pensione e parapare me nenin 16 i ligjit nr. 04/L-261. Bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se Vendimi i organit të shkallës së dytë me numër datës 22.04.2021, të cilin e atakojnë, është i drejtë dhe i bazuar në ligj sepse i njëjti është marrë pas vërtetimit të të gjitha fakteve relevante dhe është bazuar në dispozitat ligjore në fuqi që përcaktojnë statusin e pozitës që e ka mbajtur paditësi.”

Qëndrimin juridik të Gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kolegji i apelit, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m), për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e rrjedhimisht edhe e drejta materiale gjithashtu është zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Sa i përket pretendimit ankimor se Gjykata e shkallës së parë, ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, sipas vlerësimit të kolegjit të apelit ky pretendim nuk qëndron, ngase paditësi të njëjtës shkelje vetëm iu ka referuar si shkelje në hyrje të ankesës, por nuk ka theksuar saktë, përkatësisht, nuk ka specifikuar asnjë dispozitë konkrete se ku qëndrojnë shkeljet esenciale të LPPA-së, megjithatë kolegji i apelit vëren se Gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht i ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë shkelje të dispozitave të LPPA-së, dhe se aktgjykimi është hartuar në pajtim me nenin 160 të LPK-së.

Gjendja e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës të shkallës së parë, nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave procedurale dhe konstatim të gabuar të gjendjes faktike. Gjithashtu vendimi është bazuar në zbatim të drejtë të së drejtës materiale, përkatësisht në Udhëzimin Administrativ nr.01/2015 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012 për Procedurat e Aplikimit në Skemën e Pensioneve dhe Beneficioneve të Përcaktuara në Ligjin Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, kjo për faktin se nuk i ka ofruar të paditurës, e as Gjykatës dëshmi të lëshuar nga Administrata Tatimore e Kosovës, se nuk është i punësuar në asnjë institucion publik apo privat, dëshmi e cila është ndër kriteret themelore për realizmin e së drejtës për pension të veteranit të UÇK-së.

Mbi këto arsye kolegji i apelit këto pretendime ankimore i konsideron si të pa bazuara, prandaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar i Gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kolegji i apelit.

Duke vlerësuar se Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale, drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike dhe drejtë ka zbatuar të drejtën materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë së paditësit, dhe mbi këtë bazë ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Numri i lëndës: 2021:207881
Datë: 23.05.2024
Numri i dokumentit: 05725256

Mbi këto arsye, e në mbështetje të nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AA.nr.661/2023, datë;20.05.2024

Kryetari i kolegjit,
Hajriz Hoti